

VENDIM
Nr. 73, datë 12.12.2016

**AUTORIZIM I DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT
TË EKONOMISË KREATIVE (ARTIZANATIT)”**

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- Znj. Milva Ekonomi kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar;
- Z. Petrit Bakiu anëtar;
- Z. Gramoz Hoxha anëtar.

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 12.12.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETIS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, mori në shqyrtim planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”.

I. PROCEDURA

1. Planin për dhënien e ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)” është njoftuar nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (më poshtë “MZHETIS”), duke respektuar detyrimin për njoftimin e ndihmës në bazë të nenit 20, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

II. PËRSHKRIMI I MASËS

2. Objektivi: Planin për dhënien e ndihmës ka si objekt mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (SME-ve), për krijimin e kushteve lehtësuese dhe faciliteteve, me qëllim përmirësimin e klimës dhe kushteve të prodhimit dhe marketimit të produkteve artizanale, duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit, zhvillimin e sektorit të artizanatit dhe zejtarisë në Shqipëri dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

3. Baza ligjore për dhënien e ndihmës janë nenet 4, 5, 6, 7, 8 e 9, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar.

4. Kohëzgjatja: Planin e ndihmës parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2017 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare deri në vitin 2019.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe autoriteti përgjegjës për zbatimin e masës është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

6. Përfituesit: Përfitojnë nga Fondi i Ekonomisë Kreative ndërmarrjet mikro dhe të vogla, që plotësojnë, veçanërisht, kushtet e mëposhtme:

a) Janë ndërmarrje të klasifikuara si mikro ose të vogla, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar.

b) Kanë selinë ose vendin kryesor të prodhimit brenda territorit të vendit.

c) Prodhonë në Shqipëri produkte, të cilat aktualisht tregtohen brenda vendit, eksportohen jashtë ose krijojnë vende të reja pune.

7. Shtrirja territoriale: Projekti do të zbatohet në të gjithë territorin e Shqipërisë.

8. Vlera e ndihmës/Buxheti i planifikuar/ Humbjet në buxhet: Fondi total i ndihmës ka një vlerë të përgjithshme prej 30.000.000 (tridhjetë milionë) lekë, për periudhën 2017–2019. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i planit të ndihmës, përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila krijon një zë të veçantë

për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

9. Intensiteti: Në kostot e miratuara që mund të financohen nga skema përfshihen kostot për projektet që përzgjidhen nga sektori i artizanatit dhe që mbulojnë fushat e mëposhtme:

- a) zhvillimin e produkteve të reja;
- b) blerjen e pajisjeve për nxitjen e prodhimit;
- c) marketingun e produktit;
- d) kualifikimin dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore të ndërmarrjes aplikuese.

10. Forma e ndihmës dhe mjetet e financimi: Ndihma jepet në formën e grantit të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla që operojnë në sektorin e artizanatit. Për çdo ndërmarrje përfituese, në varësi të projektit konkurrues të përgatitur nga aplikantët, skema mbulon 80% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

III. VLERËSIMI I EKZISTENCËS SË NDIHMËS SHTETËRORE

11. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“2. Praktikë në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

12. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, të gjitha këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe
- c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;
- d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo formë, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”.

Burimet shtetërore

13. Zbatimi i skemës së njoftuar aktivizon burime shtetërore, sepse financohet direkt nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë (MZHE/TTS).

Bazuar në nenin 2, të ligjit nr. 9374/2005:

1. “Dhënës të ndihmës shtetërore” janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.

8. “Burime shtetërore” janë burimet e buxhetit të shtetit, përfshirë të drejtat dhe detyrimet ndaj të tretëve, titujt shtetërorë, fondet publike, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, burimet e buxhetit të njësisë të qeverisjes vendore, burimet e shoqërive shtetërore, në rastet kur këto burime nuk aktivizohen në përputhje me parimin e investitorit privat në një ekonomi tregu.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

14. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro dhe të vogla, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në projekt vendimin e Këshilli të Ministrave “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”. Përfituesit e financimit publik

kryejnë një aktivitet ekonomik në sektorin e artizanatit dhe zejtarisë duke prodhuar produkte, të cilat tregtohen brenda dhe jashtë vendit. Skema favorizon ndërmarrje të caktuara kundrejt ndërmarrjeve të tjera. Masa është selektive dhe i jep një avantazh ekonomik përfituesve të saj, pasi ato marrin nga bashkia një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk mund ta siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

15. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg. Zbatimi i skemës do të nxisë zhvillimin e aktiviteteve ekonomike në tregun e artizanatit me qëllim krijimin e produkteve të reja me origjinë shqiptare, për të cilat do të rritet interesi edhe nga ana e turistëve të huaj.

Konkluzion

Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Drejtoria vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË SKEMËS

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se:

Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon:

“1. Ndihma “De minimis” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “De minimis” përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës de minimis.

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen, njëherësh, të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi.

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”

“1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”

Sa më sipër, bazuar në ligjin “Për ndihmën shtetërore” dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma de minimis lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro dhe të vogla në vlerën maksimale prej 500.000 (pesëqind mijë) lekësh për ndërmarrje.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndihma është transparente. Granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

Nisur nga të gjitha argumentet e mësipërme, duke qenë në kushtet e përmbushjes së të gjitha kriterëve të përcaktuara nga neni 8, Komisioni vlerëson se skema “Për nxitjen e punësimit në ndihmë të krijimit të biznesit social rinor” është një skemë ndihme që lejohet.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanatit)”.
2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.
3. Çdo përfitues ndihme duhet të nënshkruajë deklaratën e ndihmës “De Minimis” (bashkëlidhur) dhe të dorëzojë një kopje të deklaratës pranë AIDA-s dhe një kopje pranë Komisionit të Ndhmës Shtetërore.
4. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.
5. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
6. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Milva Ekonomi